

## Deklaratë nga Forumi për Zonat e Mbrojtura 2023

Ne, 49 Organizata të Shoqërisë Civile, kombëtare dhe ndërkombëtare, që veprojmë në fushën e mbrojtjes së natyrës, institucione akademike-kërkimore të shkencave të natyrës, të mbledhura më 26 Janar 2023, në Tiranë në **“Forumin për Zonat e Mbrojtura 2023”**, diskutuam mbi sfidat dhe mundësitë për ruajtjen e natyrës në Shqipëri. Forumi solli para pjesëmarrësve dhe analizoi kauzat e ngritura për mbrojtjen e natyrës, hapat e ndërmarrë dhe punën e palodhshme të organizatave në drejtim të mbrojtjes së Zonave të Mbrojtura ligatinore që njihen si vatrat më të pasura të natyrës shqiptare, europiane dhe asaj botërore.

Zonat e Mbrojtura në tërësi dhe kryesisht ato ligatinore, shquhen për vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe përfaqësojnë mundësinë më të rëndësishme për zhvillimin e vendit mbi bazën e një modeli ekonomik të qëndrueshëm. Megjithatë, sot këto ekosisteme po kërcënohen gjithnjë e më tepër nga zhvillime dhe plane të paqëndrueshme që çenojnë në mënyrë të pakthyeshme tërësinë ekologjike të tyre. Këto zhvillime po mbështeten së fundmi edhe me politika dhe veprime që sjellin zvogëlim të sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura ligatinore, mos-respektim të standarteve mjedisore në veprimtari të ndryshme ekonomike duke sjellë humbje dhe degradim të habitateve natyrore. Të gjitha këto veprimtari të paqëndrueshme do të kenë ndikim të pakthyeshëm negativ në integritetin ekologjik të Zonave të Mbrojtura ligatinore, në larminë biologjike të vendit në përgjithësi dhe përbëjnë një shqetësim madhor për ne, komunitetin e mbrojtjes së natyrës dhe donatorët e përfshirë në fushën e mbrojtjes së natyrës. Nga ana tjetër, cënimi i Zonave të Mbrojtura (ZM) me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare pengon qartësisht integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Në mënyrë të veçantë, Ne, theksojmë shqetësimet e mëposhtme:

1. **Habitatet natyrore dhe të modifikuara në Zonat e Mbrojtura janë të kërcënuara nga politika dhe veprimtari të paqëndrueshme ekonomike**, sikurse urbanizimi rezidencial dhe ai në funksion të turizmit masiv, resortet e planifikuara/zhvilluara në Parkun Kombëtar Butrint, ndërtimi i zonës rezidenciale dhe të hotelerisë në Rezervatin Natyror të Menaxhuar Kune-Vain-Tale-Patok-Fushë-Kuqe-Ishëm, ndërtimi i aeroportit ndërkombëtar të Vlorës në Zonën e Pejzazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë, investimet strategjike në formën e bujqësisë intensive në Divjakë-Karavasta, hidrocentralet në Zall-Gjocaj, Valbonë, Cem etj.
2. **Zvogëlimi i Zonave të Mbrojtura ligatinore nëpërmjet Vendimeve të Këshillit të Ministrave Nr. 59/2022, Nr.60/2022 dhe Nr. 694/2022, si dhe të tjera në proces, janë tejet negative për larminë biologjike kombëtare.** Këto vendime çenojnë integritetin ekologjik të thuajse çdo ZM-je ligatinore bregdetare me mbrojtje kombëtare dhe ndërkombëtare, fragmentarizojnë ZM-të dhe habitatet e tyre, sjellin humbje të habitateve dhe specieve, si dhe krijojnë precedentin e rrezikshëm, që sa herë të ketë interesa private dhe ekonomike të paqëndrueshme, ZM-të do të tkurren për t'i lënë vend këtyre interesave;
3. **Ndikimet negative lejohen nga kuadri ligjor dhe institucional jo i plotë, zbatimi sipërfaqësor i tij dhe mungesa e bashkërendimit institucional.** Kjo sjell vendimmarrje kundër mbrojtjes së natyrës, mos-respektim të standarteve mjedisore të vendit, rritje të krimit mjedisor, mungesë transparence në vendimmarrje, si dhe keqmenaxhim të burimeve natyrore në vend.

Në përfundim, Ne, 49 Organizata të Shoqërisë Civile, kombëtare dhe ndërkombëtare, që veprojmë në fushën e mbrojtjes së natyrës, institucione akademike-kërkimore të shkencave të natyrës, kërkohet nga institucionet politikë-bërëse/vendimmarrëse dhe ato ligjzbatuese të vendit, nga Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Territorit, Komiteti i Investimeve Strategjike, Ministria

e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Brendshme, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit që çështja e ruajtjes së natyrës të kthehet në përparësi:

- (i) të ndalet vendimmarrja e gabuar në zona kyçe të biodiversitetit;
- (ii) të luftohet krimi mjedisor nga institucionet;
- (iii) të rritet transparenca dhe qëndrueshmëria në vendimmarrje;
- (iv) të rriten kapacitetet profesionale në drejtim të monitorimit, studimit dhe mbrojtjes së natyrës në institucionet e linjës;
- (v) të punohet në drejtim të monitorimit dhe vlerësimit të statusit për habitatet dhe speciet me rëndësi kombëtare/ndërkombëtare;
- (vi) të forcohet më tej bashkëpunimi me Shoqërinë Civile për një vendimmarrje sa më të qëndrueshme.

OSHC-të dhe institucionet akademike janë të gatshme të bëhen pjesë e debateve konstruktive për hartimin e politikave në mbrojtje të natyrës në mënyrë që politikat dhe programet të jenë të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse e përfaqësuese për të gjithë grupet e interesit.

*Pjesëmarrësit në Forumin për Zonat e Mbrojtura 2023.*

***Tiranë, 26 Janar 2023.***




## Aneks 2 – Agenda



TIME	TOPIC / THEMES	SESSION LEADS
<b>WELCOME</b>		
09:00 - 09:30	Registration of participants	
09:30 - 09:45	Official welcome and opening remarks	<b>Mr. Taulant Bino</b> President of AOS  <b>Her Excellency Ms. Elsa Håstad</b> Swedish Ambassador to Albania  <b>Mr. Rodion Gjoka</b> Representative of Co-PLAN
<b>SESSION ONE: PROTECTED AREAS AND THE IMPACT OF BOUNDARIES REVISION ON THE LONG-TERM PLAN</b>		
09:45 - 10:00	Presentation of the first session	<b>Mr. Ben Andoni</b> Moderator, Publicist, political analyst, civil society activist
10:00 - 10:15	The importance of Protected Areas of Albania for biodiversity conservation and the foreseen impacts of the reduction of the wetland protected areas in species and habitats of conservation concern.	<b>Mr. Taulant Bino</b> President of AOS
10:15 - 10:30	"Vjosa National Park," the approach followed for the declaration of the Protected Area	<b>Mr. Olsi Nika</b> Executive Director of EcoAlbania
10:30 - 10:45	Protected areas should not remain only on paper. The case of the Protected Area Management in Valbona Valley National Park	<b>Ms. Rea Nepravishta</b> Policy Officer, WWF ADRIA
10:45 - 11:00	Investments in Protected Areas and the relationship with the national and international legal framework for nature protection	<b>Mr. Dorian Matlija,</b> Executive Director of Res Publica <b>Ms. Irena Dule</b> Legal Representative of Res Publica





TIME	TOPIC / THEMES	SESSION LEADS
11:00 - 11:15	The importance of community involvement in protecting the ecological integrity of Protected Areas	<b>Mr. Franc Terihati</b> Executive Director of Center for Legal Empowerment
11:15 - 11:30	Discussions	
11:30 - 11:45	Coffee break	

**SESSION TWO: GOVERNANCE AND FINANCIAL MECHANISMS FOR PROTECTED AREAS**

11:45 - 11:50	Presentation of the second session	<b>Mr. Ben Andoni</b> Moderator, Publicist, political analyst, civil society activist
11:50 - 12:05	Governance and management of Protected Areas and other areas of national and international importance in Albania	<b>Ms. Daniel Pirushi</b> Director of the National Agency of Protected Areas
12:05 - 12:20	The role of the EU and the European integration process in nature protection in Albania	<b>Mr. Andrea Vera</b> Head of Sustainable Economic and Social Development, Delegation of the European Union to Albania
12:20 - 12:35	Sweden's contribution to Protected Areas and the Natura 2000 network in Albania	<b>Mr. Johan Willert</b> Programme Officer Environment and Climate Change
12:35 - 12:50	Discussions	
12:50 - 14:00	Lunch break	





TIME	TOPIC / THEMES	SESSION LEADS
<b>SESSION THREE: INVOLVING ACADEMIC AND SCIENTIFIC INSTITUTIONS IN THE FUNCTION OF NATURE PROTECTION</b>		

14:00 - 14:05	Presentation of the third session	<b>Mr. Ols Lafa</b> Moderator, Director of Center for the Development of Ancient and Medieval Albanian Heritage, Aleksandër Moisiu University
14:05 - 14:20	Involvement of academic structures in the processes of sustainable planning of the most important natural, historical and cultural areas	<b>Mr. Besnik Aliaj</b> Rector of Polis University
14:20 - 14:35	Scientific research and its contribution to the protection of nature in Albania	<b>Mr. Ferdinand Bego</b> Deputy Dean of the Faculty of Natural Sciences
14:35 - 14:50	Vlora Airport and the impact on the Vjosë-Nartë Protected Area	<b>Mr. Aleksandër Trajce</b> Executive Director of PPNEA
14:50 - 15:05	Discussions	

<b>SESSION FOUR: EXPERIENCES AND INTERNATIONAL CHALLENGES IN NATURE PROTECTION</b>		
--	--	--

15:05 - 15:10	Presentation of the fourth session	<b>Mr. Ols Lafa</b> Moderator
15:10 - 15:25	Policy and advocacy work done to protect sites from a conservation point of view in the region	<b>Ms. Sofia Capellan</b> Senior Conservation Officer Important Bird and Biodiversity Areas for Birdlife International





TIME	TOPIC / THEMES	SESSION LEADS
15:25 - 15:40	The importance of Protected Areas of Albania for species and habitats protected by AEWA and the implications deriving from the reduction of the boundaries of those Protected Areas	<b>Mr. Sergey Dereliev</b> Head of Science Implementation and Compliance Unit
15:40 - 15:55	Natural and Cultural Transboundary World Heritage Ohrid Region - Natural values and UNESCO Protection	<b>Ms. Iskra Stojkovska</b> Founder and Program Coordinator for Preservation of the Ohrid Region, Front 21/42
15:55 - 16:10	The Governance of Coastal Wetlands in the Mediterranean	<b>Mr. Flavio Monti</b> Scientific and Technical Network Manager, MedWet Secretariat
16:10 - 16:25	The international community united to preserve Mediterranean Wetlands. Successful cases supported by the Mediterranean Alliance Wetlands (MAW)	<b>Ms. Lorena Segura</b> Project Leader – Mediterranean Alliance for Wetlands - Wetlands Partnership M3, Tour du Valat
16:25 - 16:40	Coffee break	

**SESSION FIVE: GREENALL NGOS;  
ROUNDTABLE IN THEMATIC GROUPS**

16:40 - 16:45	Presentation of the fifth session (roundtable)	<b>Mr. Ols Lafa</b> Moderator
16:45 - 17:15	Discussions about "A Declaration will also be compiled from all representatives for the government."  Green-AL NGOs/ ACEG, The Resource Environmental Center in Albania, AOS, Eco Albania, Res Publica, CLE, Institute of Nature Protection in Albania – INCA, WWF Adria, Milieukontakt Albania, EDEN Center, PPNEA, NorthGreen, Agri-en, ect.	
17:15 - 17:30	Official Close of the 2023 PA Forum	





DAY 2  
DIVJAKA - KARAVASTA NATIONAL PARK  
27 JANUARY 2023

# FORUM OF PROTECTED AREAS 2023



## FIELD TRIP

- 07:00 - 07:30 Departure to Divjaka - Karavasta National Park
- 09:00 - 14:00 Birdwatching in Divjaka - Karavasta National Park
- 14:00 - 16:00 Lunch at a venue in Divjaka
- 16:00 - 18:00 Departure to Tirana



This activity takes place within Green-AL, a project financed by the Swedish International Cooperation and Development Agency (SIDA) with funding from the Swedish Government and implemented by Co-PLAN, Institute for Habitat Development in collaboration with CISP Sviluppo dei Popoli, VIS Albania and COSV - Cooperazione per lo Sviluppo.

## CHALLENGES AND OPPORTUNITIES FOR NATURE CONSERVATION IN ALBANIA





### **Aneks 3 – Organizatat nënshkruese të deklaratës**

#### **Përfaqësues të institucioneve akademike-kërkimore**

- 1) *Prof.Dr. Ferdinand Bego - Departamenti i Biologjisë – Fakulteti i Shkencave të Natyrës;*
- 2) *Dr. Ina Vejsiu – Zv. Dekane për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Institucional - Fakulteti i Shkencave Pyjore;*
- 3) *Dr. Gentjan Hykaj – Përgjegjës i Departamentit të Mjedisit – Universiteti Polis*

#### **Organizatat e Shqërisë Civile dhe institucionet akademike-kërkimore**

- 1) *AOS – Shoqata Ornitologjike e Shqiperisë;*
- 2) *Eco Albania – Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri;*
- 3) *Res Publica;*
- 4) *Co-PLAN – Instituti për Zhvillimin e Habitatit;*
- 5) *VIS Albania - Volontariato Internazionale per lo Sviluppo;*
- 6) *COSV Albania - Cooperazione per lo Sviluppo;*
- 7) *CISP-Sviluppo dei Popoli VIS Albania;*
- 8) *GO2 Albania;*
- 9) *Universiteti Polis – Departamenti i Planifikimit dhe Mjedisit;*
- 10) *FSHN – Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës;*
- 11) *EDEN - Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim;*
- 12) *PPNEA - Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri;*
- 13) *CELIM Shqipëri;*
- 14) *Milieukontakt Shqipëri;*
- 15) *REC Shqipëri – Qendra Burimore e Mjedisit;*
- 16) *WWF Adria;*
- 17) *ACEG – Albanian Centre for Environmental Governance;*
- 18) *BOA – Qendra Shpendët e Shqipërisë;*
- 19) *CLE - Centre for Legal Empowerment*
- 20) *North Green Association;*
- 21) *Well Point – Kujdes për të gjithë;*
- 22) *All Green Centre;*
- 23) *Agri-En - Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisor;*
- 24) *ETMI - Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit;*
- 25) *INLSH - Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri;*
- 26) *Agro Puka;*
- 27) *Shoqata Alpin;*
- 28) *forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës;*

- 29) *New Bridges;*
- 30) *Forumi i Mendimit te Lire;*
- 31) *H2H Foundation;*
- 32) *SDI - Social Development Investment;*
- 33) *MKEZH - Shoqata "Multifunkionale për Kulture, Edukim dhe Zhvillim";*
- 34) *Qendra Green Vision;*
- 35) *SEEP - Social Education for Environment Protection;*
- 36) *QSNM - Qendra Sociale Ne Ndhme te Njerezve ne Nevonje;*
- 37) *Shoqata Ekologët për Rajonin;*
- 38) *Nisma e Luleve;*
- 39) *Mjedisi dhe Komuniteti;*
- 40) *RurAL;*
- 41) *Lëvizja Rinore për Demokraci;*
- 42) *Organizata Menv Group;*
- 43) *Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale;*
- 44) *CERCI-Edukimi Komunitar për të Drejtat, Kulturë, Integrim;*
- 45) *Federata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Qarku Kukës;*
- 46) *Miqësia Ulëz;*
- 47) *Eco Partners for Sustainable Development;*
- 48) *New Impact;*
- 49) *MMZHT – Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit.*

## Aneks 4 – Versioni i përkthyer i deklaratës

### Statement from Protected Areas Forum 2023

We, 49 Civil Society Organizations, national and international, operating in the field of nature protection and academic-research institutions of natural sciences, gathered on January 26, 2023, in Tirana at the "Forum for Protected Areas 2023" and discussed challenges and opportunities for nature conservation in Albania. The forum brought before the participants and analyzed the causes raised for protecting nature, the steps taken, and the tireless work of organizations in protecting wetland Protected Areas, known as the richest hotspots for biodiversity in Albania, Europe, and the world.

The Protected Areas as a whole, mainly the wetlands, stand out for their exceptional natural values and represent the most crucial opportunity for the country's development based on a sustainable economic model. However, these ecosystems are increasingly threatened today by unsustainable developments and plans that irreversibly damage their ecological integrity. These developments have been supported recently with policies and actions that reduce the area of Protected Wetland Areas and non-compliance with environmental standards in various economic activities, leading to the loss and degradation of natural habitats. All these unsustainable activities will have an irreversible negative impact on the ecological integrity of the Protected Wetland Areas and the country's biodiversity in general and constitute a significant concern for us, the nature protection community, and donors involved in the field of protection of nature. On the other hand, violating Protected Areas of national and international importance clearly hinders Albania's integration into the European Union.

In particular, We emphasize the following concerns:

1. **Natural and modified habitats in Protected Areas are threatened by policies and unsustainable economic activities**, such as residential and mass tourism urbanization, planned/developed resorts in the Butrint National Park, residential, and hotel construction in the Kune-Vain-Tale-Patok-Fushë-Kuqe-Ishëm Managed Nature Reserve, the construction of the Vlora international airport in the Vjosë-Nartë Protected Landscape Area, strategic investments in the form of intensive agriculture in Divjakë-Karavasta, hydropower plants in Zall -Gjocaj, Valbone, Cem, etc.
2. **Reduction of Protected Wetland Areas through Decisions of the Council of Ministers No. 59/2022, No. 60/2022, and No. 694/2022, as well as others in the process, are highly negative for national biodiversity**. These decisions undermine the ecological integrity of almost every coastal wetland PA with national and international protection, fragment PAs and their habitats, lead to the loss of habitats and species, and create a dangerous precedent that whenever there are private interests and unstable economic conditions, PAs will shrink to accommodate these interests;
3. **Negative impacts are allowed by the incomplete legal and institutional framework, its superficial implementation, and the lack of institutional coordination**. This leads to decision-making against the protection of nature, non-respect of the country's environmental standards, increased environmental crime, lack of transparency in decision-making, and mismanagement of natural resources in the country.

In conclusion, We, 49 Civil Society Organizations, national and international, operating in the field of nature protection, academic-research institutions of natural sciences, request from the policymaking/decision-making and law-enforcing institutions of the country, from the

Council of Ministers, the National Council of the Territory, the Committee of Strategic Investments, the Ministry of Tourism and the Environment, the National Agency of Protected Areas, the National Agency of the Environment, the Ministry of the Interior, the National Inspectorate of the Protection of the Territory so that the issue of nature conservation becomes a priority , (i) stop wrong decision-making in critical areas of biodiversity, (ii) fight environmental crime by institutions, (iii) increase transparency and sustainability in decision-making; (iv) to increase the professional capacities in terms of monitoring, study and protection of nature in line institutions; (v) work towards monitoring and assessing the status of habitats and species of national/international importance, as well as (vi) to further strengthen cooperation with Civil Society for a more sustainable decision-making.

CSOs and academic institutions are ready to become part of constructive debates to design policies to protect nature so that policies and programs are sustainable, comprehensive, and representative of all interest groups.

*Participants in the Forum on Protected Areas 2023.*

***Tirana, January 26, 2023.***